FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2018 – Numri: 199

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 29 janar 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 244, datë 26.11.2018	Për miratimin e sistemit të njehsuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit e shërbimit universal të energjisë elektrike.....	15323

VENDIM
Nr. 244, datë 26.11.2018

PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË NJEHSUAR DHE TË STANDARDIZUAR TË LLOGARIVE PËR TË LICENCUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR AKTIVITETET E TRANSMETIMIT, SHPËRNDARJES DHE FURNIZUESIT E SHËRBIMIT UNIVERSAL TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 45, të ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, dhe nenit 26 të "Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s", miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 26.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve lidhur me miratimin e sistemit të njehsuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 166, datë 19.7.2018, vendosi: "Fillimin e procedurave për miratimin e sistemit të njehsuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike."

- Pas njoftimit zyrtar dhe publikimit të këtyre dokumenteve në faqen zyrtare të ERE-s, OSHEE, me shkresën nr. 16156/1 prot., datë 11.9.2018, paraqiti opinionin e Shoqërisë lidhur me miratimin e sistemit të njehsuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit e shërbimit universal të energjisë elektrike.

- Në mbështetje të nenit 13, pika 1, dhe nenit 20, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, dhe nenit 27 të "Rregullores së Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s", u zhvilluan seanca teknike me Shoqëritë për diskutimin e këtyre drafteve përkatësisht në datë 9.10.2018 me OSHEE sh.a. dhe në datë 16.10.2018 me OST-në.

- Gjatë diskutimeve me përfaqësuesit e OSHEE-së, nga ana e tyre u paraqit i vështirë detajimi i informacionit kontabël në shkallën që kërkojnë listat rregullatore, për arsye të shumta ndër të cilat dhe më kryesoret mund të përmenden:

- mungesa e një regjistri të përditësuar të aktiveve afatgjata, i cili të mundësojë klasifikimin e tyre sipas funksionit dhe destinacionit, në përputhje me kërkesat e listave të llogarive rregullatore;

- vështirësi që lidhen me organizimin e punës, i cili jo gjithmonë i përgjigjet asaj ndarjeje detyrash që kërkon evidentim të detajuar të zërave të kostove sipas listave të llogarive;

- nga ana e OST-së nuk pati reagim zyrtar dhe deri më sot pas një muaji të zhvillimit të seancës ende nuk ka ndonjë opinion mbi këto lista.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e Sistemit të Njehsuar dhe të Standardizuar të Llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike (tabelat bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Në vlerësim të konstatimeve gjatë shqyrtimit të materialit, Shoqërive iu lihet një periudhë tranzitore për paraqitjen e informacionit për vitin 2018 deri në datë 31.3.2019.
3.Drejtoria e Burimeve Njerëzore, e Administrim Financës dhe e Marrëdhënieve me Jashtë të njoftojë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

MANUALI I LLOGARIVE PËR QËLLIME TË RREGULLIMIT TË SHOQËRIVE TË LICENCUARA NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Korrik 2018

Përgatitur nga: Enti Rregullator i Energjisë

Autoriteti

"Sistemi Uniform i Llogarive" për Shoqëritë e licencuara është hartuar në përputhje me kërkesat e nenit 35 dhe 45 të ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë elektrike" (i ndryshuar), si dhe kërkesave të Standardeve Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Qëllimi:

Standardet e njehsuara të llogarive do të ofrojnë rregullat për mbajtjen e llogarive të ndara nga shoqëritë e licencuara në sektorin e energjisë elektrike, përfshirë llogaritë e aktiveve, kapitalit, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, për qëllim të llogaritjes së çmimeve dhe tarifave, sipas metodologjive përkatëse, si dhe për qëllime të monitorimit të veprimtarisë së tyre.

Zbatueshmëria e Sistemit Uniform të Llogarive

Sistemi i kontabilitetit, i specifikuar në Sistemin Uniform të Llogarive do të jetë i zbatueshëm për të gjitha Shoqëritë e licencuara të sektorit të energjisë elektrike, të cilat janë të detyruara të plotësojnë kërkesat rregullatore për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin e sipërcituar të Sektorit të Energjisë Elektrike.

A. Udhëzime të përgjithshme

1. Periudha kontabël

Shoqëritë e licencuara do t'i mbajnë llogaritë mbi baza mujore, kështu që të gjitha transaksionet e realizuara për secilin muaj do të regjistrohen në librat e tyre për atë muaj. Sasitë e transaksioneve sipas veprimtarive të Shoqërive të licencuara do të regjistrohen çdo muaj të ndara sipas veprimtarisë që kryejnë. Shoqëritë e licencuara do të mbyllin llogaritë e mbajtura për qëllime rregullatore në fund të çdo viti kalendarik, deri në një udhëzim për të vepruar ndryshe nga ERE.

2. Regjistrimet kontabël

a) Shoqëritë e licencuara do të regjistrojnë të gjitha transaksionet në librat e tyre të llogarive dhe do ta ruajnë të gjithë dokumentacionin justifikues (mbështetës) të këtyre regjistrimeve me qëllim që të mundësojnë në çdo rast kontrollin për çdo regjistrim në librin e kontabilitetit. Çdo regjistrim do të mbështetet nga një informacion i detajuar, me qëllim që të lejojë identifikim të shpejtë, analiza dhe verifikim për çdo transaksion të kryer.

b) Shoqëritë e licencuara do t'i ruajnë librat e kontabilitetit për një periudhë 10-vjeçare.

c) Shoqëritë e licencuara mund të mbajnë gjithashtu dhe dokumente të regjistrimit të përshkruara në Sistemin Uniform të Llogarive, për llogari të përkohshme, si dhe për nënndarje të llogarive të përshkruara në Sistemin Uniform të Llogarive, me qëllim që të sigurohet integriteti i informacionit dhe moscenimi i tij, i cili është shumë i rëndësishëm për qëllime rregullatore.

d) Organizimi i llogarive në sistemin Uniform të Llogarive do të shërbejë si burim të dhënash për të plotësuar aplikimet për tarifa dhe çmime që Shoqëritë e licencuara do të paraqesin në ERE.

e) sistemi i uniform i llogarive do të organizohet në mënyrën që të licencuarit të japin informacion (të paktën në nivel mesatar) në lidhje me shpenzimet dhe të ardhurat sipas natyrës dhe funksionit.

B. Politika të kontabilitetit për qëllime rregullatore

1. Financat

Fondet e Shoqërive të licencuara do të klasifikohen si fonde që lidhen me aktivet ose si fonde që lidhen me të ardhurat.

Fondet që lidhen me aktivet e Shoqërisë janë burimet e transferuara Shoqërisë, me kushtin që kjo e fundit do t'i përdorë për të blerë, për të ndërtuar ose për të marrë në pronësi aktive fikse. Kushte të tjera shtesë mund të përfshihen lidhur me vendndodhjen e aktiveve ose me periudhat gjatë të cilave këto aktive do të merren në pronësi apo do të përdoren.

Fondet, të cilat nuk janë të lidhura me aktivet do të konsiderohen si fonde të lidhura me të ardhurat.

Fondet e lidhura me aktivet do të pasqyrohen në bilanc si të ardhura të pritshme për t'u arkëtuar, të cilat do të njihen si të ardhura në përputhje me një sistem racional dhe të vazhdueshëm që do të zbatohet për periudhën e jetëgjatësisë së aktivit (*useful life of the asset*). Në

këtë mënyrë, e ardhura nga fondet që lidhen me aktivet është alokuar së bashku me amortizimin e aktivit të blerë/përftuar.

Fondet që lidhen me të ardhurat do të pasqyrohen si detyrime/huamarrje në llogaritë e të ardhurave, nën emërtimin e përgjithshëm "të ardhura të tjera financiare".

Të gjitha fondet janë përshkruar të ndara në anekset e pasqyrave financiare të Shoqërisë.

Aktivet e ndërtuara për qëllime të lidhjes së një konsumatori në rrjet dhe që janë paguar plotësisht nga konsumatori, do të trajtohen si fonde që lidhen me aktivet. Ato do të regjistrohen dhe do të pasqyrohen në llogari të veçanta.

C. Kategoritë dhe struktura e aktiveve

- Një aktiv do të konsiderohet *qarkullues* kur:

1. pritet të realizohet shitja ose të mbahet për qëllime shitjeje ose përdorimi në ciklin e operimit normal të Shoqërisë;

2. mbahet kryesisht për qëllime komerciale për një periudhë të shkurtër kohe dhe pritet të realizohet brenda një periudhe 12-mujore nga dita e pasqyrës së bilancit, ose

3. aktivi në fjalë është në para apo ekuivalente të parasë, për të cilat nuk ka kufizime për sa i përket përdorimit të tyre.

- Të gjitha aktivet e tjera do të klasifikohen si *joqarkulluese*.

Aktivet qarkulluese përfshijnë inventarin dhe kërkesat e arkëtueshme për mallrat dhe për shërbimet që janë shitur, përdorur apo realizuar si pjesë e ciklit normal të operimit të Shoqërisë, edhe në rastet kur nuk pritet që aktivet në fjalë të realizohen brenda 12 muajve të ardhshëm nga dita e pasqyrës së bilancit financiar. Letrat me vlerë të tregtueshme do të përkufizohen si aktive korrente, nëse pritet që letrat me vlerë në fjalë do të realizohen brenda 12 muajve të ardhshëm nga dita e pasqyrës së bilancit financiar; në të kundërt, ato do të konsiderohen si aktive të qëndrueshme.

Aktivet e mbajtura për përdorim të ardhshëm janë sasia (në vlerë monetare) e aktiveve që nuk përdoren aktualisht nga i licencuari për kryerjen e shërbimit. Në parim, aktivet që klasifikohen në këtë kategori janë toka dhe të drejtat e ndërtimit të kërkuara nga i licencuari. Aspekti kohor i blerjes luan një rol të rëndësishëm kur merret vendimi nëse një pronë mund të klasifikohet si aktiv i mbajtur për përdorim të ardhshëm. Aktivet që mbahen për përdorim në të ardhmen do të përfshihen në Bazën e Aktiveve të Rregulluara vetëm me miratimin e Rregullatorit.

Inventarët

a) Kostoja e inventarëve

Përkufizime:

Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të njësisë ekonomike raportuese, minus kostot e vlerësuara të kompletimit dhe kostot e nevojshme për të realizuar shitjen.

Kostoja e inventarit përfaqëson shumën e të gjitha shpenzimeve që kanë lidhje me blerjen dhe me përpunimin, së bashku me shpenzimet e tjera të kryera në lidhje me dërgimin e tyre në pikën e destinacionit dhe gjendjen e tyre.

Kostoja e blerjes së inventarit përfshin shumën e çmimit të blerjes, të taksave doganore të importit dhe të taksave të tjera (ndryshe nga ato të cilat Shoqëria mund t'i rimarrë më vonë nga autoritetet doganore), kostot e transportit dhe të tjera kosto që mund t'u ngarkohen direkt (blerjes) përftimit të mallrave, materialeve dhe shërbimeve.

Zbritjet (skontot) tregtare dhe komponentët e tjerë të ngjashëm do të zbriten gjatë llogaritjes së çmimit të blerjes.

b) Metodat:

Kostoja e atyre mallrave që nuk janë të këmbyeshme në tregje të zakonshme apo që janë të veçanta për projekte specifike, duhet të përcaktohet mbi bazën e metodës *së identifikimit specifik*.

Metoda e identifikimit specifik do të thotë që kosto të veçanta t'u atribuohen njësive të caktuara (identifikuara) të inventarit. Ky është një trajtim i përshtatshëm për njësitë e inventarit që janë alokuar në një projekt të caktuar, pavarësisht nëse këto njësi janë prodhuar apo blerë. Megjithatë, identifikimi specifik i kostove është i papërshtatshëm kur bëhet fjalë për një numër të madh të njësive të inventarit, të cilat janë zakonisht të ngjashme mes tyre (mund të shërbejnë si zëvendësues të njëri-tjetrit). Në rrethana të tilla duhet të përdoret metoda e zgjedhjes së atyre njësive që ngelen në inventarë për të përfituar efektet e pritshme mbi fitimin/humbjen neto të vitit.

Kostoja e inventarëve, përveçse e atyre që

kanë të bëjnë me paragrafin e mësipërm, duhet të alokohet duke përdorur formulat *e kostos mesatare të ponderuar*. Sipas formulës së kostos mesatare të ponderuar, kostoja e çdo njësie të inventarit përcaktohet nga mesatarja e ponderuar e kostos së njësive të ngjashme në fillim të periudhës dhe mesatarja e ponderuar e kostos së njësive të ngjashme të blera/prodhuara gjatë periudhës. Në varësi të rrethanave të Shoqërisë, kostoja mesatare mund të llogaritet periodikisht ose sipas çdo dërgese të marrë.

Kostoja e inventarëve mund të mos jetë e kthyeshme nëse inventari është i dëmtuar, nëse inventari është tërësisht apo pjesërisht jashtë përdorimit, ose nëse çmimi i tyre i shitjes është shumë i ulët. Kostoja e inventarëve gjithashtu mund të mos kthehet nëse kostot e vlerësuara të kompletimit (të ciklit të prodhimit të realizuar) apo kostot e vlerësuara për realizimin e shitjeve janë rritur. Kostoja e zvogëluar e inventarëve nuk mund të jetë më e lartë sesa vlera neto e realizueshme e tyre.

Inventari zakonisht çregjistrohet bazuar në vlerën neto të realizueshme njësi për njësi. Megjithatë, në disa rrethana, mund të jetë i përshtatshëm grupimi i njësive të ngjashme, apo i njësive që kanë lidhje me njëra-tjetrën. Ky mund të jetë rasti kur njësitë e inventarit që lidhen me të njëjtën linjë produkti apo kanë qëllime të njëjta përdorimi, janë prodhuar dhe shitur në të njëjtën zonë gjeografike. Nuk është i përshtatshëm çregjistrimi i atyre njësive të inventarëve bazuar në klasifikimin e inventarit, p.sh., mallrat ose të gjithë inventarët në një industri të veçantë apo në një segment gjeografik të veçantë. Si rregull, shoqëritë e shërbimeve akumulojnë kostot, në mënyrë që çdo shërbimi t'i aplikohet një çmim shitjeje i veçantë. Kjo është arsyeja se pse çdo shërbim trajtohet si njësi e veçantë.

Shpenzimet e shtyra sipas klasifikimit të Rregullatorit

Për qëllime të vendosjes së çmimeve/tarifave Rregullatori mund t'u kërkojë të licencuarve të trajtojnë (regjistrojnë dhe raportojnë) disa kategori të shpenzimeve, në një mënyrë të tillë që ndryshon nga praktika e zakonshme kontabël. Në këtë rast shpenzime të tilla do të regjistrohen dhe raportohen si shpenzime të shtyra rregullatore (të vendosura në llogari të veçanta) dhe do të amortizohen/regjistrohen gjatë një periudhe të caktuar kohe (këto kategori specifike të llogarive të shpenzimeve zakonisht përjashtohen nga Baza e Rregulluar). Shembuj të shpenzimeve të tilla janë shpenzime të caktuara studimi/kërkimi dhe humbjeje që lidhen me situata rastësore për arsye të rrethanave të paparashikuara, si stuhitë, përmbytjet etj. Në parim shpenzimet e shtyra rregullatore janë të pazakonshme ose ndodhin vetëm një herë.

Testi i aktivit të përdorshëm dhe të dobishëm. Testi i investimeve të kujdesshme

Të licencuarit kanë detyrimin që të sigurojnë se vetëm aktivet e përdorshme dhe të blera në mënyrë të arsyeshme janë përfshirë në Bazën e Aktiveve të Rregulluara. Rregullatori ka të drejtën të përcaktojë nëse një aset është vënë në përdorim, për çfarë periudhe ka qenë i dobishëm dhe nëse ka qenë i dobishëm për sigurimin e shërbimit për të cilin është ndërtuar. Nëse provohet që aktivi nuk kënaq kërkesat, Rregullatori mund të vendosë ta përjashtojë atë (plotësisht apo pjesërisht) nga Baza e Aktiveve të Rregulluara. Kjo kërkesë vendoset me qëllim që të diferencohet grupi i aktiveve të nevojshme për realizimin e aktiviteteve, nga kapacitetet e tepërta dhe, për rrjedhojë, të plotësojë standardet e investimeve të kujdesshme/arsyeshme.

Testi i aktivit të përdorshëm dhe të dobishëm dhe testi i investimeve të kujdesshme, përdoren për të përcaktuar nëse i licencuari ka blerë apo ndërtuar me përgjegjësi dhe rigorozitet një aset të caktuar bazuar në rrethanat dhe informacionin e kohës që është marrë vendimi për realizimin e investimit. Nëse aktivi nuk i kalon kërkesat e testit, Rregullatori mund të vendosë ta përjashtojë atë (plotësisht ose pjesërisht) nga Baza e Aktiveve të Rregulluara.

D. Vlerësimet kontabël për qëllime rregullatore

Vlerësimi i aktiveve për qëllime të vendosjes së çmimeve/tarifave

Në parim baza e aktiveve përfaqëson vlerën e aktiveve të përdorura nga Shoqëria energjitike për sigurimin e shërbimit përkatës. Të licencuarve u jepet mundësia të marrin një normë fitimi të caktuar (e vendosur nga komisioni rregullator) mbi bazën e çmimit.

Baza e çmimit mund të llogaritet nëpërmjet një ose disa kombinimeve të standardeve të kontabilitetit në vijim: kostoja historike, vlera e

tregut, kostoja e riprodhimit ose investimit të kujdesshëm. Sipas sistemit të njëjtë të llogarive, shoqëritë e licencuara do të zbatojnë metodën e miratuar nga ERE siç është përcaktuar në metodologjitë përkatëse të vendosjes së tarifave dhe të çmimeve për vlerësimin e aktiveve të tyre. Të licencuarit do të propozojnë pranë Rregullatorit metodën e vlerësimit që do të përdoret për çdo aktiv. Vlerësimet e aktiveve, bazuar në koston historike të tyre konsiderohen të pranueshme nga Rregullatori. Aty ku vlerësimet e aktiveve janë bazuar në koston e zëvendësimit apo të vlerës së tregut, ajo pjesë e vlerës mbi koston historike, nëse miratohet nga Rregullatori, mund të jetë subjekt amortizimi mbi një bazë kohore të ndryshme nga ajo e përdorur për vlerën historike të aktivit.

Aktivet e trupëzuara do të raportohen me koston e blerjes minus amortizimin e akumuluar dhe vlerën e zhvlerësimit, dëmtimeve të tyre, ndërsa toka dhe ndërtesat me vlerën e çmuar drejtësisht. Këto të dhëna duhet të paraqiten në mënyrë të detajuar nga të licencuarit.

Amortizimi dhe jetëgjatësia e Aktiveve Afatgjata Materiale

Amortizimi dhe jeta e dobishme e Aktiveve Afatgjata Materiale rregullohet nga Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IAS) dhe veçanërisht të adresuara në IAS 16, ku jepen përkufizimet në vijim:

Amortizimi është shpërndarja sistematike e vlerës së amortizueshme të Aktivit Afatgjatë përgjatë jetës së tij të dobishme.

Vlera e amortizueshme është kostoja e një aktivi ose e një vlere tjetër që zëvendëson koston, minus vlerën e rikuperueshme të aktivit.

Jeta e dobishme është:

a) periudha e kohës gjatë së cilës një aktiv pritet të përdoret nga Shoqëria; ose

b) numri i produkteve (apo i njësive të ngjashme) që pritet të përfitojë Shoqëria nga përdorimi i aktivit.

Kostoja historike (çmimi i blerjes) është shuma e parave ose e ekuivalentëve të parave të paguara ose vlera e drejtë e mjeteve të tjera, të dhëna për të blerë një aktiv në kohën e blerjes apo të prodhimit të tij.

Vlera e rikuperueshme është shuma e vlerësuar që njësia pret të përfitojë nga një aktiv në fund të jetës së dobishme, pas zbritjes së kostos së nxjerrjes nga përdorimi.

Vlera e drejtë është shuma me të cilën mund të shkëmbehet një aktiv ndërmjet palëve të mirinformuara, të vullnetshme e të palidhura me njëra-tjetrën.

Humbja nga zhvlerësimi është shuma me të cilën vlera kontabël e një aktivi e tejkalon shumën e tij të rikuperueshme, e cila përfaqëson vlerën e aktuale neto të flukseve të parasë, të skontuar me një normë interesi të tregut, të aplikueshme për klientë të ngjashëm.

Vlera kontabël neto është shuma me të cilën një aktiv njihet në bilanc (pasi zbritet amortizimi i akumuluar dhe humbjet e mundshme nga zhvlerësimi).

IAS 16 jep gjithashtu disa rekomandime mbi përcaktimin e vendndodhjes së pronës statusit të pronësisë dhe vlerësimin e jetës së dobishme të aktivit.

Vlerësimi i jetës së dobishme të aktivit:

a) Disa elemente të pasurisë, impianti dhe pajisjet duhen zëvendësuar në intervale të caktuara. Këto elemente do të llogariten për çdo aktiv veçmas, sepse ato kanë jetë të dobishme të ndryshme nga ajo e pajisjeve të cilave u përkasin. Prandaj, nëse përmbushen kriteret e njohjes, shpenzimet që bëhen për zëvendësimin ose për rinovimin e elementit llogariten si zëvendësim ose blerje e një aktivi të ri dhe aktivi i zëvendësuar çregjistrohet;

b) Shuma e amortizuar e një elementi të pasurisë, impiant dhe pajisje do të alokohet mbi baza sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Metoda e përdorur e amortizimit do të reflektojë modelin me të cilin përfitimi ekonomik i ardhshëm nga aktivi do të realizohet nga Shoqëria. Pjesa e amortizimit për çdo periudhë do të njihet si shpenzim.

c) Jeta e dobishme e një aktivi përcaktohet si periudha gjatë së cilës një aktiv të përdoret nga Shoqëria. Faktorët në vijim do të merren në konsideratë për përcaktimin e jetës së dobishme të aktivit:

- masa në të cilën kapaciteti i aktivit përdoret;
- vjetrimi i pritshëm fizik, i cili varet nga faktorë operacionalë, të tillë si numri i cikleve që aktivi përdoret dhe programi i riparimit dhe i mirëmbajtjes i Shoqërisë, si dhe kujdesi dhe mirëmbajtja e aktivit gjatë kohës kur nuk punon;
- vjetrimi teknik që vjen nga ndryshimet ose përmirësimet në prodhim, ose nga një ndryshim në

treg për produktin apo shërbimin që siguron aktivi;

- faktorë ligjorë ose të tjerë që pengojnë përdorimin e aktivit, të tillë si data e skadencës që lidhet me qiranë, licenca etj.

d) Jeta e dobishme e një aktivi përcaktohet si periudha gjatë së cilës një aktiv përdoret nga Shoqëria. Vlerësimi i jetës së dobishme të një prone, impianti dhe pajisjeje do të bazohet në eksperiencën e Shoqërisë për aktive të ngjashme. ERE do të vendosë për grupet e aseteve jetëgjatësinë sipas *bench-mark*-ut të marrë nga vendet e Europës apo të rajonit.

e) Jeta e dobishme e një elementi të pronës, impiantit dhe pajisjeve do të rishikohet periodikisht (të paktën një herë çdo tre vjet) dhe nëse parashikimi për jetën e dobishme të aktivit është shumë i ndryshëm nga vlerësimet e mëparshme, vlerësimi dhe ngarkesa e amortizimit për periudhën korrente dhe atë të ardhshme duhet të axhustohet.

f) Veç kërkesave të përcaktuara në seksionin e mëparshëm, axhustimet do të bëhen në çdo moment të jetës së aktivit nëse bëhet e qartë që vlerësimi i jetës së dobishme të aktivit është i pavend. Për shembull, jeta e dobishme mund të zgjatet nga shpenzimet në vijim mbi aktivin, ose në vazhdim të politikës së Shoqërisë për mirëmbajtje e riparime, të cilat përmirësojnë gjendjen e aktivit përtej standardit të tij të performancës së vlerësuar fillimisht. Në të kundërt, ndryshimet teknologjike ose ndryshimet në treg për produktet mund të ulin jetën e dobishme të aktivit. Në të tilla raste, jeta e dobishme dhe, si rrjedhim edhe norma e amortizimit, do të axhustohet për periudhën korrente dhe të ardhshme.

g) Politika e Shoqërisë për riparimin dhe mirëmbajtjen mundet gjithashtu që të ndikojë në jetën e dobishme të aktivit. Ajo mund të çojë në zgjatjen e jetës së dobishme të aktivit ose në vjetërsimin më të shpejtë të tij. Të tilla politika mund të inkurajohen nga ERE nëpërmjet metodës "*revenue cap regulation*" apo "*price cap regulation*". Adoptimi i politikave të tilla nuk e përjashton nevojën për të ngarkuar amortizimin e përshtatshëm.

Metodat e amortizimit, për t'u përdorur nga të licencuarit sipas sistemit të njëjtë të llogarive, do të jenë në përputhje me Sistemin Ndërkombëtar të Llogarive. Të licencuarit do t'i vërtetojnë ERE-s që amortizimi i llogaritur është në përputhje me parimet e IAS-it. Në çdo rast, ERE do të kërkojë justifikime të detajuara lidhur me vlerësimin e jetës së dobishme të aktiveve.

Në vlerësimin e jetës së dobishme Shoqëritë e licencuara mund të përdorin (a) porositë e përgjithshme të siguruara (marra) nga prodhuesit, shitësit, ndërmjetësit dhe organizatat profesionale dhe industriale, (b) informacion nga aktive të krahasueshme të Shoqërive të tjera të shpërndarjes, ose (c) informacion të brendshëm. Në përcaktimin e jetës së dobishme, të licencuarit gjithashtu duhet të marrin në shqyrtim gjendjen aktuale të aktivit dhe, për sa kohë mendohet që do të plotësojë kërkesat e shërbimit. Është e rëndësishme që ky informacion i përgjithshëm të përshtatet për kushtet specifike të të licencuarve. Faktorët e mëposhtëm duhet të merren parasysh:

- Specifikimet e cilësisë dhe ato teknike: aktive të ngjashme mund të ndryshojnë në mënyrë thelbësore në cilësi e si rrjedhim në jetën e tyre të dobishme, për shkak të diferencave në materiale, dizajn dhe mjeshtëri. Për shembull, një lloj SF6 110 kV thikë ndarëse nuk do të ketë të njëjtën jetë të dobishme si një thikë ndarëse e rregullt pneumatike (*air-filled*) 110 kV. Në të njëjtën mënyrë si materialet e përdorura për qëllime shtrimi, baza dhe shtresa e poshtme, do të ndikojnë në jetën e dobishme të një autostrade.

- Aplikimi (jeta e pritshme e përdorimit): jeta e dobishme e një lloji të dhënë aktivi mund të ndryshojë në mënyrë sinjifikative në varësi të përdorimit të paramenduar. Për shembull, jeta e një pajisjeje motorike që përdoret në shërbimin e klientit mund të ndryshojë nga jeta e së njëjtës lloj pajisjeje të përdorur për qëllime të përgjithshme dhe administrative.

- Mjedisi: ndryshimet mjedisore midis territoreve të shërbimit të të licencuarve mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në jetën e dobishme të aktiveve të tyre. Për shembull, jeta e dobishme e aktiveve në një zonë malore është ndryshe nga ajo e aktiveve të ngjashme të vendosura në një zonë me klimë të butë.

Ndikimi i mundshëm i secilit prej këtyre faktorëve mund të zbutet ose të keqësohet si rezultat i politikës së Shoqërive të licencuara për mirëmbajtjen, riparimin dhe zëvendësimin. Për

shembull, mundësia për dëmtim të transformatorit rritet nëse vaji i transformatorit nuk zëvendësohet rregullisht.

Vlerësimi i jetës së dobishme të një aktivi nuk është një ushtrim që bëhet një herë. Të licencuarit duhet të monitorojnë eksperiencat e tyre aktuale me jetëgjatësinë e AAM-ve dhe të bëjnë ndryshimet e duhura për të matur jetën e dobishme duke u bazuar mbi atë eksperiencë.

Në kushtet praktike, të licencuarit duhet të dorëzojnë në ERE raporte të veçanta të titulluara "Studim i amortizimit", të cilët përmbajnë vlerësime mbi parametrat e projektuara të jetës së dobishme dhe normat e amortizimit të aktiveve, së bashku me raportet vjetore. ERE do të shqyrtojë dhe aprovojë vlerësimet (llogaritjet) duke përdorur si referencë jetën e dobishme të mundshme dhe atë të mbetur të përdorur nga pjesëmarrësit e tjerë në industri. Parametrat e aprovuara do të përdoren nga të licencuarit gjatë jetës së dobishme të secilit aktiv.

Jeta e dobishme e mundshme dhe e mbetur për çdo aset, e paraqitur nga aplikantët do të konsiderohet e pasaktë nga ERE nëse:

1. vlerësimet nuk i korrespondojnë standardeve të industrisë;
2. vlerësimet ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga udhëzimet ndërkombëtare, ose
3. vlerësimet janë në kundërshtim me vendimet e mëparshme të ERE-s për raste të ngjashme.

ERE mund të konsiderojë si të përshtatshëm propozimin e paraqitur nga aplikantët, edhe nëse një ose më shumë nga rrethanat e sipërpërmendura janë prezente, për sa kohë që parametrat e propozuara justifikohen dhe mbrohen plotësisht.

Në kontekstin e procedurës për miratimin e tarifave, ERE mund të rishikojë jetën e mundshme dhe të mbetur të disa aktiveve dhe, nëse është e zbatueshme, të rishikojë normat e amortizimit.

Për këtë mund të shërbejnë vlerësime bazuar në eksperienca të ngjashme të vendeve të tjera apo duke marrë në konsideratë të dhënat e "*benchmark*-ut" për vendet e Europës me kushte të krahasueshme.

Kategoritë dhe struktura e Aktiveve Afatgjata Jomateriale

Kategoritë dhe struktura e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara janë hartuar në përputhje me IFRS 38 – Aktivet Afatgjata Jomateriale − dhe janë detajuar më tej për qëllime të llogarive rregullatore.

Aktivet Afatgjata Jomateriale (AAJM) janë aktive të identifikueshme jomonetare që nuk kanë përmbajtje fizike, të mbajtura për t'u përdorur për prodhimin ose furnizimin e mallrave dhe të shërbimeve, për t'u dhënë me qira të tretëve apo për qëllime administrative.

Shpenzimet për përftimin e licencës do të kapitalizohen dhe do të amortizohen sipas metodës lineare për periudhën e licencës dhe aktivet e tjera të patrupëzuara për pesë vjet. Vlera kontabël (kostoja historike minus amortizimin e akumuluar) e çdo aktivi të patrupëzuar do të rishikohet çdo vit dhe, nëse është e nevojshme, do të regjistrohet si një provizion për zhvlerësimin e aktiveve në librat e llogarive.

Aktivet e raportuara në llogaritë e sipërpërmendura duhet të përmbushin kriteret në vijim:

1. Natyrë jomonetare.
2. Të verifikueshme.
3. Aktivi është i identifikueshëm dhe mund të dallohet nga emri i mirë.
4. Mund të shiten, të shkëmbehen, të jepen me qira etj., për qëllim të marrjes së përfitimeve ekonomike nga zotërimi i tyre.
5. Përdoren për qëllime prodhimi, shërbimi, administrimi etj.

Kostot që kanë lidhje me një aktiv jomaterial, si pasojë e blerjes apo e krijimit të tyre, do të raportohen si shpenzime në momentin e kryerjes së tyre, me përjashtim të rasteve në vijim:

Kur ka të ngjarë që shpenzimet do të ndihmojnë aktivet që të gjenerojnë më shumë përfitime të ardhshme ekonomike krahasuar me ato të planifikuara fillimisht.

1. Kur këto kosto mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme dhe t'i ngarkohen aktivit.
2. Mbas kontabilizimit fillestar, AAJM-të do të raportohen me koston fillestare minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga rënia e vlerës.

Shuma e amortizueshme e një aktivi jomaterial do të shpërndahet mbi bazë sistematike gjatë gjithë jetës së dobishme të përcaktuar sipas çmuarjes më të mirë.

Amortizimi do të fillojë në momentin e marrjes së aktivit në përdorim, pra, kur ai është i gatshëm të përdoret.

Duke pasur parasysh që përfitimet e ardhshme ekonomike të materializuara në aktivet e patrupëzuara konsumohen me kalimin e kohës, vlera kontabël e aktivit do të pakësohet në mënyrë që të reflektojë këtë lloj konsumi. Kjo mund të arrihet nëpërmjet një shpërndarje sistematike të kostos fillestare (historike) të aktivit ose shumës së rivlerësuar nga e cila është zbritur vlera e mbetur, si një shpenzim gjatë jetës së dobishme të aktivit.

Amortizimi do të njihet pavarësisht nëse ka apo nuk ka rritje të vlerës së tij të përcaktuar drejtësisht apo të vlerës së rikuperueshme.

Gjatë përcaktimit të jetës së dobishme të një AAJQ-je duhet të merren në konsideratë një numër faktorësh, si:

1. Fitimi i llogaritur për Shoqërinë nga aktivi dhe nëse ky aktiv mund të menaxhohet në mënyrë efektive nga një grup tjetër menaxhimi.
2. Ciklet e jetës së një produkti tipik për aktivin dhe informacioni publikisht i disponueshëm për vlerësimet e jetës së dobishme të aktiveve të ngjashme të përdorura për qëllime të ngjashme.
3. Vjetrimi teknik, teknologjik etj.
4. Stabiliteti i sferës brenda së cilës aktivi funksionon dhe ndryshimet në kërkesën e tregut për produktin apo shërbimin e gjeneruar nga aktivi në fjalë.
5. Veprimet e mundshme të konkurrentëve ose të konkurrentëve potencialë.
6. Niveli i shpenzimeve për mirëmbajtjen e nevojshme me qëllim që të merren përfitime të ardhshme ekonomike nga aktivi dhe aftësia apo qëllimi i Shoqërisë për të arritur këtë nivel.
7. Periudha e kontrollit mbi aktivin, kufizimet ligjore dhe të tjera të përdorimit të aktivit, (si data e mbarimit të afatit të kontratës së qirasë).
8. Varësia ose mosvarësia e jetës së dobishme të aktivit nga aktive të tjera të Shoqërisë.

Jeta e dobishme e aktivit do të paraqitet në planin e amortizimit të Shoqërisë, e cila hartohet për të gjitha aktivet e patrupëzuara dhe të aprovuara nga menaxhimi.

Organizimi i llogarive sintetike të AAJM-së ka lidhje direkte me përmbajtjen e çdo objekti.

Për qëllim të llogarive rregullatore, AAJM-ve do të raportohen në llogaritë e zakonshme të grupit 20 Aktivet e Afatgjata Jomateriale mund të paraqiten në kode treshifrore.

Kategoritë dhe struktura e kërkesave për arkëtim

Kërkesat për arkëtim ndaj klientëve do të raportohen me vlerën e faturës nga e cila është zbritur një provizion për rënie vlere. Provizioni për rënie vlere do të llogaritet nëse ka njëfarë sigurie që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të arkëtojë të gjithë sasinë sipas kushteve fillestare në lidhje me vlerësimin respektiv.

Për qëllime të llogarive rregullatore kërkesat për arkëtim do të raportohen në llogaritë e grupit 41 "klientë", të shënuara me një kod treshifror.

- Llogaritë e pambledhshme - "borxhi i keq"

Përkufizimi i llogarive të pambledhshme

Llogaritë e pambledhshme do të trajtohen si shpenzime të shitjes me kredi. Arsyeja për këtë është se dhënia e kredive konsiderohet një ngjarje që rrit shitjet dhe të ardhurat. Shoqëritë janë shpesh të gatshme të pësojnë humbje nga debitorët e këqij që do të rezultojnë të paarkëtueshëm, nëse efekti neto për biznesin është rritja e shitjeve dhe fitimeve. Nga ana tjetër, të licencuarit në përgjithësi "detyrohen" të shesin me kredi për shkak të karakterit teknik të operacionit, prandaj ato i konsiderojnë "llogaritë e pambledheshme" si kosto të nevojshme.

Regjistrimi i shpenzimeve për "borxhin e keq" kërkon që shpenzimet për "borxhin e keq" të raportohen për periudhën kontabël në të cilën është realizuar shitja me kredi.

Metoda e përdorur për të regjistruar shpenzime nga "borxhi i keq" quhet "metoda e shumës së lejuar" për kontabilizimin e borxhit të keq. Përveçse kënaq kërkesat e parimit të akumulimit/rrjedhshmërisë, kjo metodë, e cila përfshin një vlerësim "të borxhit të keq", siguron gjithashtu që kërkesat për arkëtim të raportohen në pasqyrën e bilancit me vlerën e tyre neto të realizueshme. Pra, regjistrimi dhe raportimi "i borxhit të keq" mund të konsiderohet si një llogari e kundërt rregulluese e llogarive të arkëtueshme.

- Regjistrimi/kontabilizimi i "borxhit të keq"

Provizionimi i llogarive të arkëtueshme sipas "metodës së shumës së lejuar" përfshin një

llogari të kundërt rregulluese të quajtur "zbritje nga llogaria e arkëtueshme (shitje)". Regjistrimi kryhet me një debitim të llogarisë "shpenzime - borxhi i keq" dhe me kreditim të llogarisë "zbritje nga llogari të arkëtueshme (shitje)". Duhet shënuar që llogaria e kundërt rregulluese "zbritje nga llogari të arkëtueshme (shitje)" përdoret jo vetëm sepse është gjithnjë mirë të evidentohet shuma neto e llogarive të arkëtueshme, por gjithashtu edhe se në kohën e regjistrimit të rregullimit nuk specifikohen llogaritë dhe sasitë e papaguara të klientëve të veçantë. Llogaritë e klientëve të veçantë nuk mund të hiqen nga llogaritë e arkëtueshme në librin e llogarive të arkëtueshme, dhe llogaria kontrolluese për llogaritë e arkëtueshme në librin e përgjithshëm të llogarive (balanca e së cilës tregon shumën totale të llogarive të arkëtueshme në librin e llogarive të arkëtueshme) nuk mund të kreditohet me totalin "e borxhit të keq". Në vend të saj kreditohet llogaria "zbritje nga llogari të arkëtueshme (shitje)". Balanca kreditore e kësaj llogarie ka efektin e zvogëlimit të llogarisë "llogari të arkëtueshme (shitje)" në vlerën e përllogaritur neto të realizueshme të tyre.

Në pasqyrën e bilancit, llogaritë e arkëtueshme paraqiten si

Llogari të arkëtueshme (shitje) xxxx,xx

minus zbritje nga llogari të arkëtueshme (shitje) xxx.xx

Llogari të arkëtueshme (shitje) me vlerën neto të realizueshme xxxx,xx

Mënyrat e ndryshme për të marrë një vlerësim (parashikim) "të borxhit të keq" parashikohen në seksionin D.

Identifikimi dhe çregjistrimi i një llogarie të veçantë nga llogaritë e arkëtueshme (shitje)

Kur llogaria e arkëtueshme (shitje) e një klienti të veçantë identifikohet si e paarkëtueshme, ajo kreditohet përkundrejt debitimit të llogarisë "zbritje nga llogari të arkëtueshme (shitje)". Kreditimi i llogarisë "llogari të arkëtueshme (shitje)" të klientit të veçantë mënjanon sasinë "e borxhit të keq" (çregjistron llogarinë) nga libri i llogarive të arkëtueshme (ditari i shitjes), e si pasojë e çregjistron atë nga llogaritë kontrolluese të librit të madh. Fazat e këtyre regjistrimeve janë: **Së pari,** megjithëse çregjistrimi i llogarisë së një klienti të caktuar trajtohet si shpenzim, është "zbritje nga llogari të arkëtueshme (shitje)" që debitohet. Kjo për arsye se shpenzimi i llogaritur "i borxhit të keq" ishte regjistruar fillimisht si një shpenzim nga rregullimi i llogarive të arkëtueshme në fund të periudhës në të cilën ato ndodhen. **Së dyti**, megjithëse çregjistrimi eliminon sasinë e llogarive të arkëtueshme nga librat e llogarive, ai nuk ndryshon sasinë e vlerës neto të realizueshme nga llogaritë e arkëtueshme (sepse "zbritje nga llogari të arkëtueshme (shitje)" reduktohet për të njëjtën shumë).

Në rastet kur Shoqëria e licencuar mbledh një shumë që është çregjistruar më parë, ajo duhet të bëjë dy hyrje kontabël. E para do të jetë e kundërt me çregjistrimin e shpjeguar më lart dhe që rikthen në pozitën e mëparshme llogarinë e klientit. E dyta do të regjistrojë arkëtimin në llogarinë e rikthyer.

Vlerësimi (llogaritja) "i borxhit të keq"

Metoda e pasqyrës së të ardhurave (përqindja e shitjeve)

Metoda presupozon që ka një marrëdhënie të rregullt midis shitjeve të periudhave të mëparshme dhe sasisë "së borxhit të keq". Kjo marrëdhënie konvertohet në një përqindje dhe përdoret për të përcaktuar shpenzimet për "borxhin e keq" të vitit.

Metoda e pasqyrës së bilancit (përqindja mbi llogaritë e arkëtueshme)

Kjo metodë presupozon që ka një marrëdhënie të qëndrueshme midis vjetërsisë së llogarive të arkëtueshme të jashtëzakonshme dhe "borxhit te keq". Kjo marrëdhënie konvertohet në një seri përqindjesh për grupe të ndryshme vjetërsie (30, 60, 90 dhe 180 ditë), dhe përdoret për të përcaktuar shpenzimin për "borxhin e keq" të periudhës si shumë e shumave të paarkëtuara, që llogariten duke përdorur këto përqindje. Përqindja për secilin grup do të bazohet mbi informacionin statistikor. Në përgjithësi përqindja e shumave të kërkesave të paarkëtuara rritet me vjetërsinë e kërkesave për arkëtim.

Kjo metodë përdoret gjerësisht dhe konsiderohet si më e sakta. Duhet të vihet në dukje, megjithatë, se ajo cenon parimin e të ardhurave të konstatuara, prandaj nuk rekomandohet për raportime/pasqyra mujore dhe tremujore.

Shoqëria e licencuar duhet të tregojë në mënyrë të qartë se çfarë metode ka përdorur për regjistrimin "e borxhit të keq" në llogari. ERE mund t'i kërkojë Shoqërisë që të përdorë metodë tjetër për llogaritjen "e borxhit të keq".

Për qëllime të përcaktimit të tarifave të shërbimit të furnizimit universal, ERE mund të vendosë nivel kufi të njohjes së shpenzimit "të borxhit të keq", në përputhje me objektivat e caktuara për këtë tregues në planet e zhvillimit të sektorit apo të vendosur nga ERE.

Kërkesa për llogaritjen e shpenzimit "të borxhit të keq" duhet të paraqitet e alokuar sipas klasave të klientëve.

Kapitali i punës

Në përgjithësi kapitali i punës përfaqëson investimet kapitale të dhëna nga pronari gjatë intervalit midis kryerjes së shpenzimit për sigurimin e shërbimit dhe vjeljes së të ardhurave nga klientët.

RAB-i do të përfshijë kapitalin e punës në formën e një shume të lejuar për "Kapitalin e Punës" (WCA), që përfshin elemente të tilla, si para në dorë, minimumin e balancës në bankë, materiale, parapagesa dhe pagesa të taksave. Rezerva për kapitalin e punës do të jetë e mjaftueshme që të lidhë hendekun midis kohës kur paguhen kostot që sigurojnë shërbimin dhe kohës kur Shoqëria është paguar për atë shërbim.

I licencuari duhet të paraqesë një studim ku justifikon kërkesat e tij për kapital të punës. Rezervat për kapitalin e punës do të përcaktohen mbi sasinë mesatare të kapitalit të financuar nga investitorë (kapitali i vet, borxhet ose fitimet e pashpërndara në biznes), të nevojshme për financimin e kërkesave të Shoqërisë për kapitalin e punës. Shoqëria e licencuar do t'i propozojë ERE-s metodën e preferuar për llogaritjen e shumës së lejuar të kapitalit të punës (WCA). ERE mund të kërkojë përdorimin e një metode të ndryshme, nëse gjykon që metoda e përdorur nga Shoqëria nuk paraqet në mënyrë të drejtë kërkesën e saj për kapitalin e punës.

Metoda më e saktë dhe më komplekse për përcaktimin e kapitalit të punës së kërkuar është e ashtuquajtura performanca e studimit të drejtimit të vonesave "*lead/lag study*". Kjo është një detyrë gjithëpërfshirëse e kryer për të krahasuar diferencën në kohën e kryerjes ose kohën e vonesës midis hyrjeve dhe daljeve të parave. Studimi kërkon analiza të detajuara të shpenzimeve të Shoqërisë për të përcaktuar kohën në të cilën Shoqëria faktikisht duhet të paguajë për shpenzimet e saj dhe e krahason këtë me kohën në të cilën ajo merr pagesën për këto shpenzime. Diferenca kohore sipas metodës "*lead and lag*" shumëzohet pastaj me shpenzimet operative mesatare ditore për të mbërritur në nivelin e kërkuar të kapitalit të punës që do të përfshihet në RAB.

Një alternativë e kësaj metode është matja e nivelit të duhur të kapitalit të punës duke përdorur informacionin e pasqyrës së të ardhurave dhe bilancit financiar, mbi nivelin mesatar të inventarit, nivelin mesatar ditor të shpenzimeve të kryera nga i licencuari (duke përfshirë operimin, mirëmbajtjen, administrimin, taksat etj.) dhe intervalin midis daljes dhe hyrjes së parave.

Shuma e lejuar për kapitalin e punës (WCA) është shuma e dy komponentëve: shuma për kapitalin e punës "**në para**" dhe shuma për kapitalin e punës në "**materiale dhe furnizime**". Shuma e lejuar për kapitalin e punës "në para" do të përfshijë para në dorë dhe shumën minimale në "llogarinë e bankës".

Shuma e lejuar për kapitalin e punës **në para** (WCA) është një llogaritje e parasë së siguruar nga investitori për të financuar "rezervën" e paracaktuar për kostot e operimit të Shoqërisë (AUOC) në periudhën në të cilën arkëtohen të ardhurat operative. Mënyra më e mirë për të përcaktuar rezervën për kapitalin e punës **në para** është nëpërmjet studimit "*lead-lag*". *Ky studim zakonisht neglizhon vonesën në kthimin e shpenzimeve jomonetare (amortizimi, etj.) taksat e shtyra në kohë etj.*

Një studim *lead-lag* duhet të kryhet në përputhje me kriteret në vijim:

i. "Studimi *lead-lag*" do të përdorë metodën "*cash*". Të gjitha elementet jomonetare, përfshirë por jo kufizuar vetëm në amortizimin, taksat e shtyra, artikujt e parapaguar dhe fitimin (përfshi interesat mbi borxhin afatgjatë dhe dividentët) nuk do të merren në konsideratë.

ii. Çdo metodë e paanshme mund të përdoret për kryerjen e studimit *lead-lag*.

iii. Data e urdhrit të pagesës ose data e caktuar e faturës do të përdoren për qëllime të studimit "*lead-lag*". Në ato raste kur ofrohen data të ndryshme të pagesës nga shitësit/furnitorët, data

për pagesën e faturës është data korresponduese me termat e pranuara nga Shoqëria e licencuar.

